



Raporti Vjetor

2025

ASCAL / SHKURT - 2026

www.askal.al



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, vlerëson dhe monitoron cilësinë e institucionit dhe të programeve të studimit. ASCAL mbështet veprimtarinë mbi Kodin e Cilësisë në arsimin e lartë dhe standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe në funksion të analizës së ecurisë së punës gjatë vitit 2025, ASCAL harton raportin¹ e përvitshëm analitik në të cilin paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë kryesore të institucionit.

ASCAL

¹ Ky raport është dokument zyrtar i ASCAL dhe përmban informacione për të cilat ky institucion është përgjegjës. Në asnjë rast, nuk lejohet tjetërsimi apo keqpërdorimi i këtij informacioni për qëllime të tjera përveç informimit të publikut. Të interesuarit që kërkojnë të kenë këto informacione dhe t'i përdorin, ato për qëllimet e tyre, janë të lutur që zyrtarisht të kontaktojnë ASCAL.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
QUALITY ASSURANCE AGENCY FOR HIGHER EDUCATION



Adresa:

*Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr. 8, Shkalla 1, Tiranë,
Shqipëri*

Kontakt:

Tel: +355(0)2243423/2266203

E-Mail: *info@asical.al*

Website: *www.asical.al*

Shkurtime dhe fjalori shpjegues

- **ASCAL** – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë – Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit, në bazë të ligjit nr. 80/2015;
- **BA** – Bordi i Akreditimit – Organ kolegjal vendimmarrës, i cili akrediton institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit, krijuar me ligjin nr. 80/2015;
- **MA** – Ministria e Arsimit – Ministria përgjegjëse për arsimin në Republikën e Shqipërisë;
- **MPAL** – Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë;
- **IAL** – Institucion i arsimit të lartë – Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, kolegjet universitare, kolegjet profesionale të larta dhe akademitë;
- **PS** – Program studimi – Programe të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë;
- **Vlerësim / Akreditim** – Proces që ndjek ASCAL për të parë përputhshmërinë e një Institucioni të Arsimit të Lartë/programi në kuadër të akreditimit i cili kryhet nga ekspertë të fushës;
- **ENQA** – Rrjeti evropian i agjencive për sigurimin e cilësisë (**E**uropean **N**etwork for **Q**uality **A**ssurance);
- **LAL** – Ligji i arsimit të lartë;
- **KC** – Kodi i Cilësisë
- **SKS** – Sondazhi Kombëtar i Studentëve;
- **ESG** – *European standards and guidelines* – Udhëzuesit dhe standardet europiane për sigurimin e cilësisë;
- **CEENQA** – **C**entral and **E**astern **E**uropean **N**etwork of **Q**uality **A**ssurance **A**gencies in **H**igher **E**ducation;
- **EQAR** – The **E**uropean **Q**uality **A**ssurance **R**egister for Higher Education;
- **CHEA** - **C**ouncil for **H**igher **E**ducation **A**ccreditation;
- **Koordinator i IAL** – Person kontakti i caktuar nga IAL për komunikimin me ASCAL dhe shkëmbim informacioni nëpërmjet sistemit elektronik;

- **KT** – **K**oordinatori **T**eknik – Përfaqësuesi i ASCAL që ndjek një proces të caktuar të aplikuar nga një IAL;
- **EV** – **E**kspert **v**lerësimi i njohur në një fushë të caktuar i angazhuar nga ASCAL për një proces vlerësimi;
- **AMS** – **ASCAL** Management **S**ystem - Sistemi i menaxhimit elektronik i ASCAL;
- **GVB** – **G**rupi i **v**lerësimit të **b**rendshëm – Personat e angazhuar nga IAL për realizimin e një procesi vetëvlerësimi të institucionit apo programit dhe raportit të vetëvlerësimit;
- **GVJ** – **G**rupi i **v**lerësimit të **j**ashtëm – Përgjegjës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm;
- **RVB** – **R**aporti i **v**lerësimit të **b**rendshëm – Raporti i vetëvlerësimit i hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të një IAL;
- **DVV** – **D**osja e **V**etë**v**lerësimit – Dosja me dokumentacionin e plotë që përcillet nga IAL në kuadër të akreditimit të institucionit/programit;
- **DRVJ** – **D**raft**r**aport i **v**lerësimit të **j**ashtëm – Raporti paraprak i GVJ që i dorëzohet ASCAL;
- **RVJ** – **R**aporti i **v**lerësimit të **j**ashtëm – Raporti i finalizuar nga GVJ;
- **DPA** – **D**osja e **p**lotë e **a**kreditimit – Dosja me dokumentacionin e plotë e përgatitur nga ASCAL për shqyrtim në BA;
- **VBA** – **V**endimi i **B**ordit të **A**kreditimit – Vendimi i marrë nga BA pas shqyrtimit të DPA të një procesi akreditimi;
- **VKM** – **V**endim i **K**ëshillit të **M**inistrave;
- **UMA** – **U**rdhër i **M**inistrit të **A**rsimit.

TABELA PËRMBLEDHËSE

KAPITULLI I.....	7
INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE	7
1.1. HYRJE.....	7
1.2 ASCAL: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....	7
1.3 BA: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....	8
1.4 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA	8
1.5 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM.....	10
KAPITULLI II.....	12
VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL DHE BA	12
2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESEVE TË VLERËSIMIT	12
2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	12
2.3 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT	22
2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025.....	27
2.5 AKTIVITETE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRAVE INSTITUCIONALE NË BASHKËPUNIM ME MA/INSTITUCIONE TË TJERA DHE AKTIVITETE TË TJERA KOMBËTARE.....	30
2.6 BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË DHE AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE	31
2.7 AKTIVITETI FINANCIAR.....	33
KAPITULLI III	48
SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE.....	48
3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE.....	48
3.2 ADMINISTRIMI I PROCESEVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMI I CILËSISË ..	49
3.3 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT	50
3.4 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE	52
KAPITULLI IV.....	53
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2026	53

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Gjatë vitit 2025 ASCAL dhe BA kanë synuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, shtrirjen e procesit të akreditimit në sa më shumë programe studimi të ofruara nga IAL-të publike si dhe përfshirjen e studentëve në sa më shumë hallka të sigurimit të cilësisë.

Gjatë këtij viti ka avancuar më tej procesi i akreditimit institucional dhe të programeve të studimit ofruar nga IAL-të publike e private, por në të njëjtën kohë kanë vijuar edhe aplikimet nga IAL-të publike për akreditime programesh studimi.

Aktivitetet kryesore të realizuara nga ASCAL dhe BA në vitin 2025 janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë raport analitik i cili bazohet në referenca dhe të dhëna empirike. Çdo e dhënë apo informacion i paraqitur në këtë raport mund të përdoret për qëllime informimi dhe studimi, por në asnjë rast ato nuk mund të keqpërdoren, tjetërsohen apo nxirren jashtë kontekstit për të cilin janë paraqitur.

ASCAL

KAPITULLI I

INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE

1.1. HYRJE

Hartimi dhe publikimi i “Raporti Vjetor 2025” të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Bordit të Akreditimit (BA) rrjedh si detyrim nga pika 21/h e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar. Në zbatim të këtij detyrimi ASCAL harton raportin vjetor, ia paraqet për shqyrtim dhe miratim BA dhe më pas e publikon në faqen zyrtare të institucionit². Përveç përmbushjes së detyrimit ligjor, ky raport hartohet edhe në funksion të analizës së punës së ASCAL/BA.

Ky raport paraqet një përmbledhje analitike të veprimtarisë së ASCAL/BA vetëm për vitin 2025, pasi raportet paraardhëse mbulojnë veprimtarinë e viteve përkatëse.

1.2 ASCAL: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

ASCAL është person juridik publik përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë, vlerëson dhe monitoron cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Agjencia fillimisht është krijuar me VKM Nr. 303, datë 01.07.1999³ si Agjencia e Akreditimit, riorganizuar në Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë me VKM Nr. 424, datë 02.06.2010⁴, dhe riorganizuar në Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë me VKM Nr. 109, datë 15.02.2017⁵, të ndryshuar.

Agjencia ka si mision promovimin dhe sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë bazuar në disa parime themelore si: **(1)** respektimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë (IAL); **(2)** transparencën dhe informimin në çdo hap të

² Raporti vjetor për vitin 2025 u shqyrtua dhe miratua nga BA me vendimin Nr. 64, datë 08.05.2026 dhe është publikuar në faqen zyrtare të ASCAL, ku mund të gjenden gjithashtu të publikuara edhe Raportet e viteve të mëparshme.

³ VKM nr. 303, datë 01.07.1999 “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë”.

⁴ VKM nr. 424, datë 02.06.2010 “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”

⁵ VKM nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, ndryshuar me VKM Nr. 825, datë 24.12.2021.

procesit; **(3)** mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL; **(4)** objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe **(5)** respektimin e kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë si dhe të standardeve Europiane të cilësisë. Në veprimtarinë për përmbushjen e misionit të saj, Agjencia gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të cilat publikohen dhe bëhen transparente për aktorët në fushën e arsimit të lartë.

1.3 BA: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

Pranë ASCAL funksionon Bordi i Akreditimit si organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij. BA është vazhdues i punës së Këshillit të Akreditimit⁶ i krijuar në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007.

Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e BA rrjedhin prej Ligjit 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar. Bordi i Akreditimit ka pavarësi në funksionimin e tij përsa i përket akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë.

BA përbëhet nga 11 anëtarë të cilët janë personalitete të botës akademike me eksperiencë në fushën e akreditimit, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit. Ligji Nr. 80/2015 i jep fuqinë BA-së të marrë vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që ato ofrojnë. BA bashkëpunon me institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë, politikëbërjes dhe vendimmarrjes duke dhënë rast pas rasti rekomandime për çështje të ndryshme që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Aktiviteti i BA mbështetet nga ASCAL.

1.4 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA

Organizimi dhe funksionimi i ASCAL

Struktura e Agjencisë është në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 20, datë 26.01.2021 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”*, i ndryshuar. Agjencia është organizuar në katër sektorë dhe numri i punonjësve është 18. Struktura organizative përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, Sektori i Statistikave dhe Analizave, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin. Çdo

⁶ Për here të parë Këshilli i Akreditimit është krijuar me VKM nr.303, datë 01.07.1999.

sektor drejtohet nga përgjegjësi përkatës. ASCAL ofron asistencën teknike për institucionet e arsimit të lartë, BA, ekspertët e vlerësimit të jashtëm dhe bashkëpunëtorët e tjerë.

Baza ligjore e funksionimit të ASCAL/BA

Në Shqipëri sistemi i akreditimit ka një përvojë mbi 20 vjeçare dhe ka ardhur duke u konsoliduar gradualisht. Disa nga dokumentet/aktet kryesore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e ASCAL/BA janë:

- Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*;
- VKM Nr. 109, datë 15.02.2017 *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”*, i ndryshuar;
- VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*, i ndryshuar;
- Urdhërat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin të cilat kanë efekte mbi procedurat e ASCAL në kuadër të vlerësimit të jashtëm dhe marrëdhëniet me institucionet e arsimit të lartë;
- Rregullore *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”*, miratuar nga BA me Vendim Nr. 72, datë 10.09.2022;
- *“Rregullore për funksionimin e brendshëm të Bordit të Akreditimit”*, miratuar nga BA me Vendim Nr. 224, datë 15.12.2023;
- *“Kodi i Etikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”*, miratuar me urdhër Nr. 153, datë 13.12.2023;
- *“Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area”* (Standardet dhe udhëzimet të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë 2015). Këto standarde janë reflektuar në dokumentet bazë të funksionimit të ASCAL si procedura të vlerësimit/akreditimit, etj.;
- Manuali për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe

programeve të studimit 2017 si dhe aspekte dhe procedura të miratuara nga BA (për periudhën përpara miratimit të Manualit të ri) dhe Manuali 2025 “Për procedurat e sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar;

1.5 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në ushtrimin e veprimtarisë funksionale në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit, ASCAL dhe BA angazhojnë ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe/apo konsulentë. Gjatë vitit 2025 ASCAL dhe BA kanë përditësuar listën e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, vendas dhe të huaj, bazuar në kualifikimet e tyre si dhe aftësinë për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

Bordi i Akreditimit, me vendim Nr. 146, datë 21.06.2025, miratoi listën e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm për vitin 2025. Kjo listë përbëhej nga rreth **477** ekspertë.

Gjatë këtij viti është vijuar me përfshirjen dhe angazhimin e ekspertëve të huaj në akreditimin institucional dhe të programeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Në koordinim të vazhdueshëm, ASCAL dhe BA kanë pasuruar/përditësuar listën me ekspertë të huaj, sidomos të atyre që vijnë nga diaspora akademike shqiptare.

Gjithashtu, në muajin Dhjetor të vitit 2025, është hapur thirrja e re për ekspertë të vlerësimit të jashtëm⁷, përmes së cilës profesionistë të fushave akademike dhe të kërkimit shkencor janë ftuar të aplikojnë për t’u përfshirë si Ekspertë të Vlerësimit të Jashtëm.

Kriteret e përcaktuara në këtë thirrje për tu përmbushur nga ekspertët përfshijnë:

➤ **Kritere të detyrueshme:**

- Të zotërojnë të paktën gradën shkencore “Doktor”, ose “PhD” të fituar jashtë Shqipërisë.
- Të këtë të paktën 5 vite përvojë akademike, dhe të jetë i/e punësuar si personel akademik me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë, ose institut kërkimor-shkencor.
- Të ketë një sërë studimesh të cilësisë së lartë të botuara në revista shkencore cilësore dhe me impakt të lartë në fushën e tij/saj specializimit.

⁷<https://www.ascal.al/sq/informacione/lajme/thirrje-per-eksperte-te-vleresimit-te-jashtem-2025-12-15>

- Të ketë përvojë në mësimdhënie dhe të ketë marrë pjesë (ose drejtuar) hartimin e programeve të reja të studimit dhe/ose të kurrikulave mësimore në fushën e saj/tij të studimeve.
- Të ketë njohuri akademike të gjuhës angleze dhe të jetë në gjendje të shkruajë materiale akademike në gjuhën angleze.

➤ **Kritere te dëshirueshme:**

- Përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.
- Njohuri të proceseve të vlerësimit në kuadër të akreditimit institucional, si dhe programeve të studimit në Shqipëri dhe/ose jashtë vendit.
- Përvojë në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë.
- Njohuri për tregun e punës dhe perspektivat e punës në fushën/disiplinën përkatëse.

Pasi të përfundojë shqyrtimi i aplikimeve nga Bordi i Akreditimit, lista e ekspertëve do të miratohet në vijim në vitin 2026.

KAPITULLI II

VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL DHE BA

2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESSEVE TË VLERËSIMIT

ASCAL, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, përgatit dhe përmirëson vazhdimisht, në koordinim me BA, dokumentat dhe formatet e nevojshme për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Në muajin Dhjetor të vitit 2025, ASCAL ka rishikuar Manualin për procedurat e sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, si dhe ka filluar punën për rishikimin e formateve të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Gjatë vitit 2025, akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe i programeve të studimit që ato ofrojnë ka vijuar të jetë aktiviteti kryesor i ASCAL dhe BA. Në këto procese ASCAL dhe BA mbështeten në Kodin e Cilësisë (VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, i ndryshuar) dhe standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

Bazuar në Manualin e Procedurave 2017 dhe Manualin “Për procedurat e sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë”, procesi i akreditimit është i ndarë në faza:

Faza e aplikimit - shqyrtimi i aplikimeve

Bazuar në Manualin e ASCAL 2017, IAL-të duhet të aplikojnë për akreditimin institucional ose të programeve të studimit, në formë zyrare dhe nëpërmjet sistemit online të menaxhimit të ASCAL (ASCAL Management System – AMS) brenda periudhës 1 Tetor – 31 Maj. Me ndryshimet e miratuara në Manualin 2025, për aplikimet e reja për vitin 2026, periudha e aplikimit do të jetë 1 Nëntor-31 Maj.

Në vitin 2025, në ASCAL janë paraqitur dhe **janë shqyrtuar 250 aplikime të reja** për akreditim ose riakreditim. Nga këto: **9 aplikime** për akreditim institucional dhe **241 aplikime** për akreditim programi.




Figura 1: Aplikime të shqyrtuara në vitin 2025

Specifikisht, gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar 9 aplikime për **akreditim institucional**, nga të cilat:

- **4** IAL publike;
- **5** IAL jopublike.

Të gjitha këto aplikime janë në kuadër të akreditimit periodik institucional.

Aktualisht, nga 9 aplikimet për akreditim institucional, 3 janë në proces akreditimi dhe 6 janë në proces verifikimi, në pritje të përmbushjes nga IAL të kriterëve ligjore/dokumentacionit të kërkuar nga ASCAL.



Figura 2: Aplikimet e shqyrtuara për akreditim institucional, 2025

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar **241 aplikime** për **akreditim programesh**, nga të cilat:

- **140** aplikime nga **9** - IAL publike;
- **101** aplikime nga **23** - IAL jopublike.



Figura 3: Aplikimet e shqyrtuara për akreditim programesh, 2025

Përsa i përket llojit dhe ciklit të këtyre aplikimeve, të dhënat paraqiten në vijim:

- **13** programe studimi me karakter profesional;

- **89** programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”;
- **39** programe studimi të ciklit të dytë “Master Profesional”;
- **71** programe studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
- **10** programe të integruara studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
- **1** program studimi të ciklit të dytë “Master i Arteve”;
- **1** program studimi të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”;
- **1** program studimi të ciklit të tretë Specializues Afatgjatë;
- **16** programe studimi të ciklit të tretë “Doktoratë”.



Figura 4: Aplikimet e programeve, 2025 (cikli/lloji)

Për IAL publike, aplikimet për akreditim programi sipas ciklit/llojit në vitin 2025 paraqiten si në vijim:

- **4** programe studimi me karakter profesional;
- **40** programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”;
- **29** programe studimi të ciklit të dytë “Master Profesional”;
- **46** programe studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
- **6** programe të integruara studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
- **1** program studimi të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”;

- **14** programe studimi të ciklit të tretë “Doktoratë”.




Figura 5: Aplikimet e programeve nga IAL publike, 2025 (ciklit/lloji)

Për IAL jopublike, aplikimet për akreditim programi sipas ciklit/llojit në vitin 2025 paraqiten si në vijim:

- **9** programe studimi me karakter profesional;
- **49** programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”;
- **10** programe studimi të ciklit të dytë “Master Profesional”;
- **25** programe studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
- **4** programe të integruara studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”;
- **1** program studimi të ciklit të dytë “Master i Arteve”;
- **1** program studimi i ciklit të tretë Specializues Afatgjatë;
- **2** programe studimi të ciklit të tretë “Doktoratë”.




Figura 6: Aplikimet e programeve nga IAL jopublike, 2024 (cikli/lloji)

Aktualisht, prej 241 aplikimeve për akreditim programi, 118 prej tyre janë në proces akreditimi, 117 janë në proces verifikimi në pritje të përmbushjes nga IAL të kërkesave nga ASCAL dhe 6 janë anuluar për shkak të tërheqjes së vetë IAL.

Faza e aplikimeve është përmbyllur me miratimin e kërkesës dhe periudhës së vlerësimit, e cila i bëhet me dije IAL-ve sipas parashikimeve të Manualit.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, krahasuar me vitin 2024, evidentohet një rritje e ndjeshme e numrit të aplikimeve nga IAL-të. Konkretisht, numri total i aplikimeve është rritur nga 149 në 250, duke shënuar një rritje prej rreth 67.8%. Kjo rritje reflektohet si në aplikimet për akreditim institucional, të cilat janë shtuar nga 6 në 9, ashtu edhe në aplikimet për akreditim programesh, të cilat janë rritur nga 143 në 241.

Në ndarjen sipas kategorive të institucioneve të arsimit të lartë, vihet re një rritje e konsiderueshme e aplikimeve si nga IAL publike, ashtu edhe nga ato jopublike. Në vitin 2024, aplikimet për akreditim programesh nga IAL publike ishin 71, ndërsa në vitin 2025 ato arrijnë në 140, duke u pothuajse dyfishuar. Nga ana tjetër, aplikimet nga IAL jopublike janë rritur nga 72 në 101, duke reflektuar gjithashtu një rritje të qëndrueshme, megjithëse me ritëm më të moderuar krahasuar me IAL-të publike.

Gjatë fazës së shqyrtimit të aplikimeve janë kryer verifikime në disa aspekte.

Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin institucional dhe programeve të studimit*, verifikimet janë bazuar në:

- Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu III “Institucionet e arsimit të lartë”, Neni 17-29; Kreu V “Organizimi akademik dhe administrativ i institucioneve të arsimit të lartë”, Neni 36-56 dhe Kreu VII “Organizimi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69-73, 77, 79-84;
- Udhëzimin e MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 “*Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, etj.

Verifikimet paraprake janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të themelimit, organizimit dhe funksionimit të IAL-ve;
- verifikimin e të dhënave të përgjithshme të institucionit si:
 - përmbushja e kërkesave ligjore të organizimit të institucionit;
 - përmbushja e kërkesave ligjore të strukturës akademike;
 - numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, drejtuesve të IAL, njësive bazë/kryesore;
 - numri i studentëve, programeve/fushave të studimit që ofron institucioni;
- verifikimin mbi masat e marra nga institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik);
- shqyrtimin e akteve ligjore të hapjes, organizimit dhe funksionimit të programit të studimit;
- verifikimin e të dhënave të përgjithshme të programit si:
 - përmbushjen e kërkesave ligjore të organizimit/strukturës së programit të studimit;

- përputhshmërinë e emërimit të programit të studimit me aktet që lidhen me organizimin/ funksionimin e tij;
- numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, të njësisë bazë/kryesore që ofron programin e studimit;
- numri i studentëve për programin e studimit;
- verifikimin mbi masat e marra nga Institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik).

Nga shqyrtimi i aplikimeve për akreditim, gjatë vitit 2025, janë hasur problematika të lidhura kryesisht me:

- mosplotësimin e numrit dhe shkallës së kualifikimit të stafit akademik, drejtuesve të IAL-së, njësisë bazë/kryesore, sipas legjislacionit në fuqi;
- mungesën e informacionit/dokumentacionit të akteve të hapjes së programeve të studimit apo mospërputhje të emërtimeve të programeve (në aplikimet e IAL-ve publike të cilat i nënshtrohen procesit të akreditimit për herë të parë);
- ndryshimet statutore apo organizative të IAL-ve të realizuara pas aplikimit për akreditim, të cilat impaktojnë drejtpërdrejt procesin e akreditimit;
- konstatimin e disa rasteve të punësimit me kohë të plotë të personelit akademik në dy ose më shumë IAL në të njëjtën kohë;
- vonesat nga IAL-të në përcjelljen e dokumentacionit/saktësimeve të kërkuara apo reflektimit të plotësimeve të kërkuara, etj.

Këto problematika dhe vështirësi kanë sjellë shpesh herë vonesa në përfundimin e verifikimit të aplikimeve dhe vijimin e procesit të akreditimit.

Faza e vlerësimit – vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm

Pas përfundimit të verifikimit paraprak, procesi kalon në fazën e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

Vetëvlerësimi përkundrejt standardeve të Kodit të Cilësisë bazohet në përgatitjen dhe paraqitjen e të dhënave institucionale, hartimin e raporteve të vetëvlerësimit dhe të dokumentacionit mbështetës/verifikues të vlerësimit. Në këtë kuadër, IAL-të dorëzojnë dokumentet përkatëse që përbëjnë Dosjet e Vetëvlerësimit (DVV). Dokumentacioni

paraqitet në 2 gjuhë (shqip dhe anglisht) për proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, programeve të integruara të ciklit të dytë si dhe të programeve të ciklit të tretë të studimeve.

Vlerësimi i jashtëm bazohet në analizën, vlerësimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe vlerësimin përmes vizitës në institucion. Grupet e vlerësimit të jashtëm kanë vlerësuar dhe dakordësuar gjykimet pjesore e tërësore për të gjitha institucionet dhe programet e vlerësuara në mënyrë kolegjiale. Vlerësimi mbi bazë dokumentacioni është pasuar me vizitën në institucion dhe hartimin e raportit përfundimtar bazuar në dy komponentët e vlerësimit. Grupet e vlerësimit kanë kryer vizita 2-ditore në IAL-të përkatëse për çdo proces, ku kanë zhvilluar takime sipas agjendave të dakordësuara dhe dërguar paraprakisht institucioneve.

Në përfundim, grupet e vlerësimit të jashtëm kanë hartuar draft-raportet e vlerësimit të cilat u janë dërguar institucioneve për komente apo sqarime. Proceset janë përmbyllur me hartimin e raportit përfundimtar i cili, përveç pjesës së vlerësimit përkundrejt standardeve, përcakton “gjetjet” e vlerësimit ku përfshihen pikat e forta, të dobëta dhe rekomandimet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Mbështetur në rezultatet e vlerësimit përkundrejt standardeve, ekspertët japin gjykimet e tyre në lidhje me fushat e veçanta dhe vlerësojnë shkallën e përmbushjes e Standardeve të Cilësisë sipas kategorive:

- *Nuk përmbushen;*
- *Përmbushen pjesërisht;*
- *Përmbushen kryesisht;*
- *Përmbushen plotësisht.*

Gjatë vitit 2025, në ASCAL **janë përfunduar 165 procedura**, nga të cilat: **4** akreditime institucionale dhe **161** akreditime të programeve të studimit. Këto procedura lidhen me aplikimet e paraqitura nga IAL-të gjatë periudhave të aplikimit edhe në vitet paraardhëse, të cilat janë përmbyllur gjatë vitit 2025.

Të dhënat për procedurat e akreditimit sipas llojit të programeve paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Procedurat e akreditimit sipas llojit të akreditimit Institucional dhe të programeve

Llojet e vlerësimeve	Numri i procedurave të përfunduara, të shqyrtuara në Bord	Numri i procedurave të përfunduara, të pa shqyrtuara në Bord	Totali
Programe me karakter profesional (2 vjeçare)	8	2	10
Bachelor	55	2	57
Master Profesional	32	3	35
Master i Shkencave / Arteve	39	2	41
Master i Shkencave (PI)	9	1	10
SPA	5	1	6
Master Ekzekutiv	0	0	0
Doktoratë	2	0	2
Akreditime institucionale	4	0	4
Në total	154	11	165

Në kuadër të procedurave të akreditimit, ASCAL ka realizuar trajnime me grupet e vlerësimit të brendshëm (GVB) dhe grupet e vlerësimit të jashtëm (GVJ). Në këto trajnime grupet njihen me mënyrën e hartimit të raporteve të jashtëm dhe të brendshëm, menaxhimin dhe verifikimin e dokumentacionit për proceset e vlerësimit, organizimin dhe koordinimin e vizitës në institucion, etj.

Gjatë vitit 2025, ASCAL ka realizuar trajnime dhe vizita në institucione si vijon:

- **56 ekspertë** të trajnuar në grup dhe individualisht;
- **230 ekspertë** të angazhuar në kuadër të akreditimeve nga të cilët 13 të huaj dhe 217 vendas;
- **165 vizita** në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit;
- **280 ditë** vizitash të realizuara në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit.

2.3 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT

BA funksionon pranë ASCAL bazuar në VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar dhe ka kompetencën e vendimmarrjes për akreditimin e IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Vendimi për akreditimin mund të jetë pozitiv ose negativ. Në rastin e një vendimi pozitiv, BA shprehet për kohëzgjatjen dhe vlefshmërinë e akreditimit dhe mund të vendosë rekomandime për institucionet në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

Në muajin nëntor 2025, Bordi i Akreditimit u rikonstituua me përbërjen e re, të emëruar me Urdhër të Kryeministrit nr. 191, datë 16.10.2025. Në këtë kuadër, Prof. Shqiponja Telhaj u rizgjodh Kryetare e Bordit të Akreditimit, ndërkohë që një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të mandatit të parë vijuan angazhimin edhe në mandatin e ri. Kjo vazhdimësi në përbërjen dhe drejtimin e Bordit reflekton rëndësinë e ruajtjes së kujtesës institucionale, konsistencës në vendimmarrje dhe vijimësisë së proceseve të nisura për forcimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.

Mbledhjet e BA organizohen në bazë të një kalendari të hartuar në përputhje me numrin e aplikimeve që janë për t'u shqyrtuar.

Në lidhje me aktivitetin e BA, disa nga veprimtaritë kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2025 janë si vijon:

- *Shqyrtimi dhe vendimmarrja në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;*
- *Shqyrtimi i aplikimeve dhe miratimi i listës së ekspertëve;*
- *Organizimi/pjesëmarrja i aktiviteteve në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.*
- *Përgatitja e një dokumenti që sugjeron përmirësime të procesit të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.*

Gjatë vitit 2025, Bordi i Akreditimit në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 393 datë 29.06.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave *"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë"*, të ndryshuar, ka realizuar **12** mbledhje. Në mbledhjet e realizuara BA ka marrë vendime si më poshtë:

Tabela 2: Aktiviteti i detajuar i BA

Aktiviteti i BA 2025									
	Mbledhja BA	Vendime	Akreditim IAL				Akreditim programi		Vendime Proceduriale
			Akreditim i Plotë		Akreditim i Pjesshëm		IAL Publike	IAL Jopublike	
			Publike	Jopublike	Publike	Jopublike			
	10 Janar	21	0	0	0	0	6	14	1
	07 Shkurt	14	0	0	0	0	10	4	0
	28 Shkurt	10	0	0	0	0	10	0	0
	01 Mars	7	0	0	0	0	0	7	0
	04 Prill	11	1	0	0	0	5	5	0
	09 Maj	11	0	0	0	0	9	2	0
	10 Maj	10	0	0	0	0	9	0	1
	20 Qershor	39	0	2	0	0	21	16	0
	21 Qershor	23	0	0	0	0	1	20	2
	14 Nëntor	14	0	1	0	0	5	7	1
	12 Dhjetor	26	0	1	0	0	11	15	0
	13 Dhjetor	19	0	0	0	0	9	9	1
Total		205	1	4	0	0	96	98	6

Tabela 3: Aktiviteti i përmbledhur i BA

INSTITUCIONET	PUBLIKE	JOPUBLIKE	TOTALI
Akreditime IAL i plotë	1	4	5
Akreditime IAL të pjesshme	0	0	0
Akreditime programesh	96	98	194
Tjetër (ndryshim vendimesh, etj)	6		6
TOTALI	97	102	205

Bazuar në VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar, BA shqyrton ankesat/kërkesat e IAL-ve mbi procesin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe shprehet me vendim/shkresë të arsyetuar në lidhje me këto ankesa/kërkesa, duke vendosur pranimin ose mos pranimin e ankesës. Për vitin 2025, BA ka shqyrtuar 12 ankesa/kërkesa dhe është shprehur për secilën me një vendim/shkresë të arsyetuar.

Rezultatet e akreditimit të IAL-ve dhe programeve të studimit, raportet e vlerësimit dhe vendimet përkatëse të BA janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të ASCAL. Në vendimmarrjet e shqyrtuara gjatë vitit 2025, BA ka dhënë 198 **vlerësime pozitive** për institucionet dhe programet e studimit të vlerësuara dhe 1 **vlerësim negativ**.

Ndarja sipas kategorive dhe kohëzgjatjes së vlerësimit, jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelat më poshtë.

Tabela 4: Të dhëna për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit

Vendimmarrja për:	Kohëzgjatja e akreditimit (vite)							
	0	1	2	3	4	5	6	Tjetër ⁸
Akreditim Institucional	0	0	0	1	2	2	0	0
Akreditim i Pjesshëm	0	0	0	0	0	0	0	0
Akreditim Programesh	1	0	9	36	86	48	7	7
Total	1	0	9	37	88	50	7	7

Tabela 5: Të dhëna për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit për programet e studimit

Vendimmarrja për	Kohëzgjatja e akreditimit (vite)							
	0	1	2	3	4	5	6	Tjetër ⁹
Akreditim DP			2	1	6	4	1	1
Akreditim Bsc			5	17	36	17	3	3

⁸ BA është shprehur për akreditimin e programeve të studimit për breza të caktuara të studentëve të regjistruar/diplomuar në to si edhe për akreditimin e pjesshëm të institucioneve.

⁹ BA është shprehur për akreditimin e programeve të studimit për breza të caktuara të studentëve të regjistruar/diplomuar në to.

Akreditim MP			0	9	14	8	2	1
Akreditim Msc / MA			2	8	21	17	1	1
Akreditim Msc PI			0	1	5	2	0	1
Akreditim SPA/ ME/DR	1		0	0	4	0	0	0
Total	1	0	9	36	88	48	7	7

Përveç vendimmarjes për akreditimin e IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë, BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar edhe në një sërë veprimtarish që lidhen me punën e BA, ku ndër të tjera mund të përmendim Sondazhin Kombëtar të Studentëve.

Gjatë vitit 2025, BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar në hapjen e thirrjes për ekspertë të vlerësimit të jashtëm nga Diaspora akademike Shqiptare si dhe miratimin e listës së ekspertëve, duke vënë fokusin tek përfshirja e diasporës akademike shqiptare. Gjithashtu, në kuadër të forcimit të cilësisë së proceseve të vlerësimit të jashtëm, gjatë vitit 2025 Bordi i Akreditimit ka vijuar të ushtrojë një rol aktiv në rishikimin dhe përmirësimin e listës së ekspertëve të vlerësimit. Përveç miratimit të listës së ekspertëve për vitin 2025, Bordi ndërmori një shqyrtim të kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës të CV-ve dhe përvojës profesionale të ekspertëve të përfshirë në listë, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara dhe sigurimin e një baze më të konsoliduar ekspertësh për proceset e vlerësimit të jashtëm. Ky proces kontribuoi në përditësimin e listës së ekspertëve dhe në rishikimin e mëtejshëm të angazhimit të ekspertëve në proceset e akreditimit, në funksion të rritjes së cilësisë, profesionalizmit dhe besueshmërisë së vlerësimeve.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, Bordi i Akreditimit ka ndjekur me vëmendje cilësinë e raporteve të hartuara nga ekspertët e angazhuar në proceset e akreditimit. Në rastet kur raportet e vlerësimit nuk kanë reflektuar nivelin e duhur të analizës, objektivitetit dhe argumentimit mbi përmbushjen e standardeve të cilësisë, Bordi ka evidentuar problematikat përkatëse dhe ka marrë masa për të mos vijuar angazhimin e ekspertëve në fjalë në procese të mëtejshme. Kjo qasje synon të forcojë besueshmërinë, profesionalizmin dhe qëndrueshmërinë e vendimmarrjes në proceset e akreditimit.

Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ishte pjesëmarrja e Bordit të Akreditimit në prezantimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar i Politikave Arsimit të Lartë 2030. Në muajin shkurt 2025, Prof.

Shqiponja Telhaj, në cilësinë e Kryetares së Bordit të Akreditimit, ishte pjesëmarrëse dhe folëse në takimin e drejtuar nga Ministria e Arsimit, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Shqipërisë dhe drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë në vend. Në këtë takim, Kryetarja e Bordit paraqiti një përmbledhje të punës së Bordit, si dhe gjetjet kryesore të raportit të përgatitur nga Bordi mbi tendencat dhe sfidat e cilësisë në arsimin e lartë. Këto gjetje u reflektuan si pjesë e Dokumentit Strategjik Kombëtar për Zhvillimin e Arsimit të Lartë.

Përfshirja e gjetjeve të raportit të Bordit në këtë dokument strategjik përbën një kontribut të rëndësishëm të Bordit të Akreditimit në procesin e politikëbërjes dhe në përcaktimin e prioritetëve kombëtarë për zhvillimin e arsimit të lartë. Ky angazhim dëshmon rolin e Bordit jo vetëm si organ vendimmarrës në proceset e akreditimit, por edhe si një aktor që kontribuon në analizën e sistemit, identifikimin e sfidave kryesore dhe orientimin e masave për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ishte prezantimi i gjetjeve të raportit të përgatitur nga Bordi i Akreditimit mbi tendencat e cilësisë në arsimin e lartë në Shqipëri. Në muajin korrik 2025, në një takim të organizuar me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Shqipërisë, Ministres së Arsimit dhe drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë, Kryetarja e Bordit të Akreditimit, Prof. Shqiponja Telhaj, së bashku me anëtarin e Bordit, Prof. Iraj Hashi, prezantuan gjetjet kryesore të këtij raporti. Raporti evidentoi tendencat kryesore, arritjet, sfidat dhe çështjet që kërkojnë vëmendje të mëtejshme në kuadër të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Ky prezantim përbën një kontribut të rëndësishëm të Bordit të Akreditimit jo vetëm në procesin e akreditimit, por edhe në diskutimin më të gjerë strategjik dhe politikëbërës mbi cilësinë e arsimit të lartë në vend. Përmes analizës së të dhënave, përvojës së akumuluar nga proceset e akreditimit dhe evidentimit të problematikave të përsëritura në sistem, Bordi ka kontribuar në identifikimin e prioritetëve për përmirësimin e cilësisë, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe forcimin e mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

Në zhvillimin e aktititetit të tij BA ka patur mbështetjen e ASCAL. Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin ka mbështetur aktivitetin e BA duke kryer këto funksione:

- Ndjek procedurat të cilat kalojnë për shqyrtim në mbledhjen e BA;

- Harton draft-agjendën dhe ia përcjell për sugjerime/konfirmim BA;
- Përgatit dosjen me dokumentacionin e nevojshëm për mbledhjen e BA, sipas agjendës së mbledhjes;
- Kujdeset për hapjen, mbarëvajtjen dhe përditësimin e procedurës së hapur në sistemin AMS për mbledhjen e BA;
- Mban kontakte me BA duke informuar për çështjet që lidhen me BA;
- Mban procesverbalin e mbledhjes së BA, ia përcjell anëtarëve të BA dhe sigurohet që të siglohet nga të gjithë anëtarët në mbledhjen e radhës;
- Arkivon dokumentacionin që lidhet me mbledhjet e BA;
- Drafton, zbardh dhe publikon shkresat / vendimet e BA;
- Regjistron certifikatat e akreditimit institucional/programeve të studimit në regjistrin e certifikatave dhe njofton IAL për tërheqjen e tyre.

2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Bazuar në ligjin nr. 80/15 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"* dhe VKM nr. 109, datë 15.02.2017 *"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë"*, i ndryshuar, një nga mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i mësimdhënies edhe nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). SKS ka si qëllim kryesor sigurimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e institucioneve të arsimit të lartë në kuadër të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave, nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve. Po ashtu, me anën e këtij sondazhi, vlerësohen edhe aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit të IAL në kuadër të vendimmarrjes dhe politikëbërjes në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Përgjatë vitit 2025, vijoi puna për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për vitin akademik 2024-2025. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në cilësinë e institucionit përgjegjës, administroi tërësisht procesin, duke hartuar dhe zbatuar metodologjinë, ndërtuar instrumentet për zhvillimin e sondazhit, organizuar kalendarin e veprimtarive dhe siguruar burimet njerëzore e financiare të nevojshme

për zbatimin e tij. Metodologjia, plani i veprimit dhe pyetësi për realizimin e sondazhit u miratuan nga Bordi i Akreditimit.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë bashkëpunoi ngushtësisht me Këshillat Studentorë në çdo institucion, duke i përfshirë studentët në diskutime dhe konsultime për përmirësimin e pyetësorit dhe procedurave të zhvillimit të sondazhit, por gjithashtu edhe si pjesë të grupit të punës të ngritur nga ASCAL për zhvillimin e këtij procesi.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, ASCAL ka qenë në kontakt me IAL-të për nisjen e SKS. U njoftuan titullarët e institucioneve për zhvillimin e SKS dhe iu kërkua të përgatisin dhe dorëzonin listat e studentëve me kontaktet e tyre, si dhe të ngrihej grupi i punës në nivel IAL-je për koordinimin e procesit brenda çdo institucioni. Në faqen zyrtare të ASCAL u hap seksioni i posaçëm i SKS në të cilin u publikuan informacionet dhe aktivitetet e zhvilluara. Agjencia u angazhua tërësisht në përgatitjen e infrastrukturës, ku përfshihej platforma, databaza, serveri për ruajtjen dhe arkivimin e informacioneve, etj. Njëkohësisht u informuan institucionet me procesin, planin e veprimtarive, si dhe me agjendat për takimet trajnuese/informuese me grupet e punës dhe studentët.

Më datë 19 Mars 2025, ASCAL filloi turin e takimeve informuese për SKS. Gjatë periudhës 19 Mars – 14 Prill u zhvilluan 82 takime me grupet e punës dhe me studentë të IAL-ve përkatëse. Në disa prej IAL-ve me numër të madh njësisish kryesore dhe studentësh, u realizuan disa takime, sipas njësive kryesore. U kontaktuan/trajnuan rreth 245 anëtarë të grupeve të punës të ngritur pranë IAL-ve dhe rreth 4000 studentë të cilëve u është shpërndarë dhe broshura informuese e përgatitur për këtë qëllim. Takimet janë zhvilluar në të gjithë IAL-të e vendit në 8 qytete (Shkodër; Tiranë; Durrës; Elbasan; Pogradec; Korçë; Vlorë; Gjirokastrë). Aktivitetet në kuadër të këtyre takimeve janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të ASCAL¹⁰.

Për të garantuar zbatimin në terren, brenda çdo institucioni u ngritën grupe pune, ku përfshiheshin edhe studentë. Këto grupe u kujdesën për koordinimin e procesit, shpërndarjen e informacionit dhe krijimin e kushteve praktike për plotësimin e pyetësorëve. Institucionet e Arsimit të Lartë vunë në dispozicion listën e studentëve aktivë me adresat e tyre elektronike, si dhe sallat apo laboratorët e informatikës për të mundësuar plotësimin e pyetësorëve në mënyrë të organizuar. Megjithatë, theksohet se institucionet nuk patën asnjë të drejtë të

¹⁰ <https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/takimet-informuese/takimet-informuese-2025>

ndërhyjnë apo të ndikojnë në gjykimin e lirë të studentëve, duke respektuar parimin e anonimatit dhe pavarësisë së përgjigjeve. Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë ndoqi hap pas hapi ecurinë e procesit, duke garantuar transparencë dhe korrektësi.

Paralelisht me zhvillimin e takimeve informuese, vijoi puna për përgatitjen e infrastrukturës për zhvillimin e SKS. Gjatë periudhës 17 Mars – 18 Prill 2025 ASCAL finalizoi versionin online të SKS duke:

- përgatitur në platformë pyetësorin në tre gjuhë: shqip/anglisht/italisht;
- përgatitur formatet e komunikimit me studentët: teksti hyrës i sondazhit; formatet e ftesës, email konfirmimi; email kujtese, etj;
- kryer testet e nevojshme me pyetësorin online;
- krijuar pyetësorët e dedikuar për çdo IAL.

Në datën 21 Prill 2025 u hap zyrtarisht dhe u shpërnda SKS me email në adresat e studentëve në 38 Institucione të Arsimit të Lartë në vend (14 IAL publike dhe 24 IAL jopublike). Gjatë periudhës së plotësimit të Sondazhit, ASCAL ka mbajtur komunikime të vazhdueshme nëpërmjet AMS me koordinatorët e IAL-ve, ku i ka informuar për nivelet e pjesëmarrjes dhe ka kërkuar prej tyre marrjen e masave për informimin e vazhdueshëm të studentëve për zhvillimin e SKS.

Gjatë fazës së plotësimit të SKS, studentët kanë patur ndihmën e ASCAL nëpërmjet komunikimeve në adresat e email survey@ascal.al dhe info@ascal.al, ku kanë mbërritur komunikime të ndryshme nga studentë të cilët janë ndihmuar/sqaruar nga ASCAL për zgjidhjen e problematikave të hasura prej tyre, të lidhura kryesisht me probleme teknike për aksesimin e sondazhit, apo ankesa se nuk u ishte dërguar email për plotësimin e sondazhit. ASCAL u është përgjigjur të gjithë emaileve të dërguara nga studentët. Për rastet e mungesës së emailit për plotësimin e sondazhit, ASCAL ka bërë verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar që kontaktet e tyre mungonin në listat e dërguara nga IAL. Në total u vunë në dispozicion 115.538 kontakte studentësh nga të gjitha IAL-të. Pas verifikimeve teknike, rezultoi se 113.672 adresa e-mail ishin funksionale dhe të mbështetura nga platforma e SKS, prej të cilave 79.678 i përkisnin institucioneve publike dhe 33.994 institucioneve jopublike. Gjatë fazës së plotësimit të sondazhit janë zhvilluar veprimtari promovuese në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, median audiovizive dhe rrjetet sociale, duke patur në fokus studentët, sensibilizimin dhe informimin e tyre për SKS. Me qëllim sigurimin e një

pjesëmarrjeje më të lartë të studentëve në SKS, u vendos shtyrja e afatit të mbylljes së SKS deri më datë 6 Qershor 2025. Me mbylljen e platformës online, u eksportuan rezultatet, u realizua përpunimi statistikor i tyre dhe rezultatet shoqëruar me analizat përkatëse, janë bërë pjesë e një raporti përmbledhës me rezultatet e SKS. Raporti përmbledhës, përpara publikimit, u shqyrtua edhe nga Bordi i Akreditimit.

Të gjitha dokumentat lidhur me Sondazhin Kombëtar të Studentëve janë të publikuara në faqen zyrtare të ASCAL www.ascal.al.

2.5 AKTIVITETE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRAVE INSTITUCIONALE NË BASHKËPUNIM ME MA/INSTITUCIONE TË TJERA DHE AKTIVITETE TË TJERA KOMBËTARE

Gjatë vitit 2025 ASCAL ka marrë pjesë në të gjitha grupet e punës, aktivitetet dhe punën për hartimin e dokumentacionit përkatës në kuadër të plotësimit të kushteve për anëtarësimin në Bashkimin Europian, si dhe aktivitete të tjera kombëtare të organizuara në fushën e arsimit të lartë dhe me fushën e saj të veprimtarisë.

ASCAL ka qenë/vazhdon të jetë pjesë e grupeve të punës, konkretisht në:

1. Hartimin e dokumentave në kuadër të plotësimit të dokumentacionit për kapitujt 25 dhe 26, të Integrimit Europian;
2. Pjesëmarrëse si anëtarë të grupit të Shqipërisë Bologna Follow-up Group (BFUG), në të gjitha aktivitetet e organizuara;
3. Pjesë e grupit të punës për hartimin e Dokumentit të Politikave të Arsimit të Lartë 2030;
4. Pjesë e grupeve të punës në kuadër të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore nga ana e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri;
5. Pjesë e grupit të punës për hartimin e Ligjit për Shkencën në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025, ASCAL ka marrë pjesë në takimet/aktivitetet kombëtare në vijim:

1. Takime me drejtues dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, publike dhe jopublike, në kuadër të bashkëpunimit të

vazhdueshëm ndërinstitucional për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë;

2. Pjesëmarrje në takimet/trajnimet e organizuara nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKSK);
3. Pjesëmarrje në Ceremoninë e Bluzave të Bardha 2025-2026, të organizuar nga Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në datë 6 Tetor;
4. Pjesëmarrje në workshop-in e organizuar nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPSSC), i Universitetit të Tiranës, me temë *“Analiza e treguesve të cilësisë dhe rishikimi i politikave të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Tiranës”*, më datë 20 Nëntor.

2.6 BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË DHE AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

ASCAL është anëtare me të drejta të plota në CEENQA, INQAAHE, dhe anëtare e asociuar e ENQA. Agjencia ka bashkëpunuar aktivisht me këto rrjete, ka marrë pjesë në veprimtaritë e organizuara prej tyre dhe veçanërisht në aktivitetet e organizuar nga ENQA.

Gjatë aktiviteteve ku ka marrë pjesë, ASCAL ka prezantuar dhe informuar bashkëpunëtorët për aktivitetet që kryen dhe angazhimet për anëtarësimin me të drejta të plota në ENQA dhe regjistrimin në EQAR. Përfundimet e nxjerra nga këto aktivitete kanë qënë objekt diskutimi në ASCAL dhe janë reflektuar në aktivitetin e Agjencisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 ASCAL ka ndërtuar ura bashkëpunimi me aktorë vendas dhe të huaj për të marrë pjesë si institucion partner në programe të financuara nga Bashkimi European që kanë në fokus arsimin e lartë, strukturimin e programeve të studimit dhe kurrikulave, lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës si dhe sigurimin e cilësisë. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2025, ASCAL është bërë pjesë e disa konsorciumeve që kanë aplikuar për financim nga programi Erasmus+ i Bashkimit European. Konferencat dhe aktivitetet që ASCAL mori pjesë në vitin 2025 janë:

1. Takimi në kuadër të projektit *“Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e arsimit dual në arsimin e lartë në Shqipëri (DUALBA)”*, i zhvilluar në Universitetin e New York-ut në Tiranë, në datat 3-4 Shkurt;

2. Seminari i tretë i organizuar nga ENQA për Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë të cilat po përgatiten për një vlerësim të jashtëm në përputhje me ESG 2015, i zhvilluar në Madrid, Spanjë, në datat 27-28 Mars;
3. Forumi i Anëtarëve të ENQA-së 2025, me temë “*Qëndrueshmëria në Sigurimin e Cilësisë*”, i zhvilluar në Paphos, Qipro, në datat 9-11 Prill;
4. Takim në kuadër të projektit “*Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e arsimit dual në arsimin e lartë në Shqipëri (DUALBA)*”, i zhvilluar në Graz, Austri, në datat 14-16 Prill;
5. Workshop i organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në bashkëpunim me Agjencinë Kroate për Shkencën dhe Arsimin e Lartë (ASHE), me temë “*Forcimi i agjencive të sigurimit të cilësisë në Ballkanin Perëndimor: mjetet, pajtueshmëria dhe gatishmëria për ENQA*”, i zhvilluar në Zagreb, Kroaci, në datat 24-25 Prill;
6. Konferenca e 18-të Bienale e INQAAHE, e zhvilluar në Tokio, Japoni, në datat 13-16 Maj;
7. Konferenca Ndërkombëtare mbi Standardet e Cilësisë së Arsimit (ICEQS-25), e zhvilluar në Frankfurt, Gjermani, në datat 30-31 Maj;
8. Aktiviteti i përvitshëm i organizuar nga Rrjeti i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEENQA), i zhvilluar në Talin, Estoni, në datat 13-14 Qershor;
9. Takimi në kuadër të projektit “*Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e arsimit dual në arsimin e lartë në Shqipëri (DUALBA)*”, i zhvilluar në Bilbao, Spanjë, në datat 23-25 Shtator;
10. Konferenca e 3-të Vjetore e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), e zhvilluar në Prishtinë, Kosovë, në datën 30 Shtator;
11. Takimi “*Advancing Quality Assurance and Recognition in the Western Balkans*”, i zhvilluar nga Academic Cooperation Association (ACA), në kuadër të nismave të Bashkimit Evropian për forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurimit të cilësisë dhe njohjes së diplomave në vendet e Ballkanit Perëndimor, i zhvilluar në Tiranë, në datat 9-11 Tetor;
12. Asambleja e Përgjithshme e ENQA-s dhe aktivitetet e 25-vjetorit, e zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, në datat 22-24 Tetor;

13. Takimi në kuadër të projektit APEL-WB – *“Accreditation of Prior Experiential Learning Capacity-Building in the Western Balkans”*, të zhvilluar në Tiranë, në datat 20-22 Nëntor;
14. Takimi në kuadër të Projektit *“Strengthening of relations between HEIs and industry sector through Dual Education in Albania and Kosovo with the focus on ICT (DUALKO)”*, i zhvilluar në Elbasan, në datat 11-12 Dhjetor.

2.7 AKTIVITETI FINANCIAR



Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”*, Ligjit *“Për buxhetin e vitit 2019”*, Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar, Ligjit 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”* dhe Vendimit Nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”*, i ndryshuar, ASCAL financohet në mënyrë të balancuar nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj. Nga viti 2019 deri në vitin 2025 nuk janë akorduar fonde nga buxheti i shtetit.

ASCAL ka kryer dhe mbështetur aktivitetin e saj financiar për vitin 2025 vetëm nga të ardhurat e siguruar nga veprimtaria e saj si në tabelën më poshtë:

Tabela 6: Buxheti nga të ardhurat dhe realizimi për vitin 2025

Nr.	Kap	Emërtimi	Llogaria ekonomike	Plani/ lekë	Fakti/lekë	Realizuar në %
1	6	Paga	6000000	33,000,000	25,564,458	77.4%
2	6	Sigurime shoqërore	6010000	5,709,305	3,915,634	68.5%
3	6	Shpenzime operative	6020000	76,358,406.3	46,415,688.44	60.7%

4	6	Shpenzime operative	6050000	1,501,399	498,601	33.2%
5	6	Shpenzime operative	6060000	20,000	20,000	100%
6	6	Shpenzime për investime	2310000	2,000,000	119,999	5.9%
		Totali		118,589,110.3	76,534,380.4	



Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga ASCAL sipas Ligit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, shpërndahen 10% në buxhetin e shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë. Ato evidentohen, autorizohen dhe përdoren me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 6 “Të ardhura jashtë limitit”.

ASCAL trashëgon të ardhura vetëm nga viti 2025 në vlerën 58.365.102,6 lekë dhe të ardhura ndër vite 60.224.007,7 lekë, duke siguruar një buxhet për vitin 2025 në vlerën: 118.589.110,3 lekë, fonde sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602, shpenzime operative 605, shpenzime operative 606 dhe investime 231).

Tabela 7: Të ardhura të arkëtuara për vitin 2025

Nr.	Kap.	Të ardhura 2025	Lloji i të ardhurave	Arkëtuar	Pjesa e Buxhetit	Pjesa e institucionit	Rritje e autorizuar
1	6	7190990	Shërbimet që kryen ASCAL institucioneve të arsimit të lartë	64,850,114	6,485,011.4	58,365,102.6	58,365,102.6
			Totali	64,850,114	6,485,011.4	58,365,102.6	58,365,102.6

Vlerën **58,365,102.6 lekë** (90% të të ardhurave të arkëtuara nga IAL-të) në zërin *shpenzime operative*, ASCAL-i e përdor në funksion të tyre për:


- Për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj , të cilët janë kontraktuar nga ASCAL;

- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Bordit të Akreditimit;
- Për pagesën e anëtarëve të Bordit të Akreditimit dhe shpenzime të tjera të tij;
- Për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucione ndërkombëtare;
- Për pagesat për udhëtime dhe dieta të stafit të ASCAL për aktivitetet e zhvilluara jashtë vendit;
- Për investime.

Tabela 8: Përdorimi i të ardhurave për vitin 2025

Shpenzimet operative / Llogaria ekonomike 602.0000				
Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Gjendja e trashëguar deri me 31 dhjetor të vitit 2025	Përdorur në fakt	% që zë secili zë në totalin e shpenzimeve
1	Shpenzime operative	76,534,380.44		
2	Shpenzime për pagesën e honorareve të Bordit të Akreditimit (Të huaj dhe vendas)		7,967,175	10%
3	Shpenzime për pagesën e honorareve të ekspertëve vendas dhe të huaj		23,095,657	30%
4	Shpenzime udhëtim e qëndrimi brenda dhe jashtë vendit të punonjësve të ASCAL, Bordit të Akreditimit dhe ekspertëve të huaj		9,251,000	12%
5	Shpenzime të ndryshme, detyrime ndaj të tretëve, qera salle, shtypshkrime, përkthime organizime workshop etj.		6,745,428	8%

6	Shpenzime për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizatat		507,401	0.7%
	TOTALI		47,466,661	61%



Të ardhurat nga Projekti Dualba

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është pjesë e Projektit **GRANT AGREEMENT Project 101179734—DUALBA.**

“Marrëveshja” është nënshkruar midis palëve të mëposhtme: nga njëra anë, Agjencia Ekzekutive Evropiane e Arsimit dhe Kulturës (EACEA)

“Agjencia Ekzekutive e BE-së” ose “Autoriteti dhënie”, sipas kompetencave të deleguara nga Komisioni Evropian dhe nga ana tjetër.

1. “Koordinatori”:

UNIVERZITET U NOVOM SADU (UNS), PIC 998833833, established në DR ZORANA DINDICA 1, NOVI SAD 21000, Serbi.

2. “Përfituesi”:

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILESISE NE ARSIMIN E LARTE (ASCAL), PIC939567706, established në RRUGA E DURRESIT PRANE GJIMNAZIT QEMAL STAFI, TIRANË 1001, Shqipëri,

Në llogari të përfituesit ASCAL në muajin maj 2025 është disbursuar fondi prej 849,401.36 lekë.

Ky fond është përdorur për organizimin e aktiviteteve të organizuara nga partnerët në Mondragon, (Spanjë), në Graz (Austri), në Tiranë dhe staff costs, dhe në 31.12.2025 gjendja e këtij rimbursimi është zero (0).

Të ardhurat nga Projekti LOGOS

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është pjesë e Projektit Ndërkombëtar për Ndërtimin e Kapaciteteve në fushën e Arsimit të Lartë.

Kjo Marrëveshje e Konsorciumit, e referuar më poshtë si "Marrëveshja", është bërë dhe lidhur nga dhe midis palëve të mëposhtme: nga njëra anë,

- KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS (LOGOS)

dhe nga ana tjetër,

- AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILESISE NE ARSIMIN E LARTE (ASCAL), PIC 939567706,

Në llogari të përfituesit ASCAL në muajin nëntor 2025 është disbursuar fondi prej **3,023,854.94 lekë**, i cili nuk është përdorur ende për asnjë aktivitet të planifikuar nga projekti.

ASCAL ka aktivizuar ekspertë të kualifikuar akademike për vlerësimin e jashtëm të programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë.

- **Gjatë vitit 2025 për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional si dhe të programeve të studimit janë kryer pagesat për:**

A. Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i programeve dy vjecare profesionale:

a. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

DP. “Menaxhim dhe MarketingTurizmi”

b. Kolegji Universitar “Reald”

DP. “Asistent Administrativ”

c. Kolegji Profesional i Tiranës”

DP. “Teknologji Ndertimi

d. Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë

DP. “Mbështetës zyre për komunikimin, bibliotekë dhe arkivë”

e. Kolegji Universitar “i Biznesit”

DP. “Teknik i Lartë elektrik”, me profile: Energjitik;
Automatizim industrial; Elektromekanik;

DP. “Teknik i Lartë Automobilah”, me profile: Automekanik;
Autotronik; Hibrid dhe Elektrike;

DP. “Teknik i Lartë”, me profile: Sisteme kompjuterike;
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Grafik Web dhe
Multimedia Dizajn”;

f. Universiteti “Metropolitan Tirana”

DP. “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente”;

B. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të parë:

a. Universiteti “Albanian University”:

Bsc. “Financë-Bankë”

Bsc. “Fizioterapi”;

Bsc. “Inxhinieri Mekatronike”;

Bsc. “Dizajn”;

Bsc. “Anglisht”;

b. Universiteti Politeknik i Tiranës:

Bsc. “Inxhinieri e naftes dhe Gazit”;

Bsc. “Inxh. e Burimeve Natyrore”;

Bsc. “Inxh. Gjeomjedisi”;
Bsc. “Inxhinieri Gjeoinformatike”;

c. Universiteti “Luarasi”:

Bsc. “Infermieri”;
Bsc. “Financë-Bankë”;

d. “Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”:

Bsc. “Komunikim dhe Maredhenie me Publikun”;
Bsc. “Shkenca politike dhe Administrative”, me profile:
Politikat e Integritetit dhe Qeverisje; Administratë Publike;
Bsc. “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”;

e. Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër:

Bsc. “Administrim Publik”;

f. Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë:

Bsc. “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje”;
Bsc. “Mësuesi për Arsimin Fillor”;
Bsc. “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”;
Bsc. “Edukim Fizik dhe Sporte”;
Bsc. “Infermieri e Përgjithshme”;
Bsc. “Informatikë Biznesi”;
Bsc. “Mami”;
Bsc. “Infermieristikë”;

g. Universiteti “Aldent”:

Bsc. “Teknikë Laboratori Mjekësor”;
Bsc. “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”;

gj. Kolegji Universitar “LOGOS”:

Bsc. “Financë-Kontabilitet”;
Bsc. “Punë Sociale”;

h. Universiteti i Tiranës:

Bsc. “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”;
Bsc. “Gazetari dhe Komunikim”;
Bsc. “Administrim dhe Politikë Sociale”;
Bsc. “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”;
Bsc. “Ekonomiks”;
Bsc. “Financë”;
Bsc. “Gjeografi”;

i. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë:

Bsc. “Teknikë Laboratori”;
Bsc. “Studime në Shkenca Ushtarake”;

j. Universiteti “REALD”:

Bsc. “Informatikë ekonomike”;
Bsc. “Teknik në Radiologji Mjekësore, Imazheri dhe Radioterapi”;

k. Universiteti “Western Balkans”:

Bsc. “Inxhinieri Biomjekësore”;
Bsc. “Bioteknologji”;
Bsc. “Fizioterapi”;
Bsc. “Infermieri”;
Bsc. “Teknik Laboratori”;
Bsc. “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”;
Bsc. “Teknik Imazherie”;

l. Universiteti European i Tiranës:

Bsc. “Informatikë Ekonomike”;
Bsc. “Psikologji”, me profil “Shëndet mendor”;

m. Kolegji Universitar “BEDËR”:

Bsc. “Financë-Kontabilitet”;
Bsc. “Shkenca Komunikimi”;
Msc. “Imazheri dhe Radioterapi”;
MP. “Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë”;

n. Universiteti “Barleti”:

Bsc. “Fizioterapi”;

Bsc. "Infermieri";

nj. Universiteti i Arteve:

Bsc. "Muzikë Jazz";

Bsc. "Perkusion";

Bsc. "Aktrim";

Bsc. "Koreografi";

Bsc. "Skenogradfi-Kostumografi";

Bsc. "Regji";

Bsc. "Regji Filmi dhe Televizioni";

o. Universiteti "Polis":

Bsc. "Administrim Biznesi";

p. Akademia e Forcave të Armatosura:

Bsc. "Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes"

Bsc. "Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes";

C. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë

a. Universiteti "Barleti":

Msc (PI). "Arkitekture";

Msc. "Puna Sociale ne Sistemin Arsimor";

Msc. "Psikologji Klinike";

Msc (PI). "Drejtësi";

b. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër:

MP. "Mësues në Arsimin Special";

MP. "Administrim Publik";

c. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë":

Msc. "Teknik Laboratori";

Msc. "Informatike" me profile: "Sistemet e Informacionit ne Biznes"; "Inxhinieri Softëare";

Msc. "Psikologji", me profile: "Psikologji Organizative"; "Psikologji Komunitare"; "Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor";

d. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës:

Msc. “Mësues për Arsimin në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi – Gjuhë Angleze”;

MP. 2 vj. “Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsi”;

Msc. “Menaxhim Marketing”;

MP. 2 vj. “Shërbime Sociale dhe Komunitare”;

MP. “Drejtimi i SME-ve”;

e. Universiteti i Sporteve i Tiranës:

Msc. “Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”;

MP. “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”;

Mp. 1 vjeçar. “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”;

Msc. “Aktiviteti fizik dhe shëndeti”;

f. Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë:

Msc. “Etika dhe Lidërsipë”

MP. “Administrim Biznesi”

MP. “Drejtim Agrobiznesi”

MP. “Menaxhim i Qendrueshëm në Agroturizëm”

MP. “Menaxhim i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve”

Msc. “Kulture media dhe Editim”

MP. 1 vj. “Administrim Biznesi”

MP. “Sistemet moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit”

Msc. “Financë”

MP. “Bankë dhe Sigurime”

MP. “Marketingu Digital”

g. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë:

MP. “Infermieri Familje”;

MP. “Menaxhim Infermieror”;

Msc. “Teknikë Laboratori”;

MP. “Teknikë Laboratori”;

gj. Kolegji Universitar “LOGOS”:

MP. 2 vj. “Teologjia Sociale dhe Praktike”;

Msc. “Përkthim Profesional”;

h. Akademia “Nehemiah Gateway”:

Msc. “Menaxhim”, me profil “Biznes”;

i. Universiteti “Luarasi”:

Msc. “E Drejtë Penale”;
Msc. “E Drejte Civile dhe Tregtare”;
MP. 1 vj. “Siguria Kibernetike dhe e Informacionit”;
MP. 1 vj. “Siguria dhe Rendi Publik”;

j. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”:

Msc. “Financë dhe Kontabilitet”;
Msc. “Financë dhe Bankë”;
Msc. “Kontabilitet dhe Auditim”;

k. Universiteti Privat “Albanian University”:

MP.2 vj. “Qeverisje dhe Administrim Publik”;
Msc. “Administrim Publik” me profile: Politika Publike dhe BE; Politika Publike dhe Qeverisje;
Msc (PI) “Farmaci”;
MP. “Interier Dizajn”;
Msc (PI) “Drejtësi”;
MP. 2 vj. “Menaxhim Bankar dhe Financiar”;

1. Universiteti i Tiranës:

Msc. “Perkhim teknik-letrar dhe interpretim”;
MP 2 vj. “Psikologji Ligjore”;
Msc. “Filozofi Sociale”;
Msc. “Administrim i Sherbimeve Sociale”;
Msc. “Mësuesi për gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë”;
Msc. “Psikologj” me profil “Psikologji shkollore”;
Msc (PI). “Drejtësi”;
MP. “Zgjidhje e konflikteve me ndërmjetësim”;
MP. “Gazetari Investigative”;
Msc. “Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore”;
Msc. “Fizikë”;
MP. “Qeverisja dhe Politikat Publike”;
Msc. “Inxhinieria e proceseve kimike”;
Msc. “Histori”;
Msc. “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
Msc. “Matematikë”;
Msc. “Marrëdhënie Ndërkombëtare”;
Msc. “Financë” me profile: Drejtues Financiar; Ndërmjetës bankar; Ndërmjetës jobankar;
Msc. “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale”;
Msc. “Statistika Zyrtare”;

m. Kolegji Universitar “Tirana Bussines University”:

MP.1 vj. “Administrim Biznesi”, me profile: Menaxhim;
Kontabilitet-Financë;
MP. 2 vj. “Adm.Biznesi”, me profile: Menaxhim; Kontabilitet-
Financë; E Drejtë Biznesi;

n. Universiteti European i Tiranës:

Msc. “Inxhinieri Ndërtimi”, me profile: Infrastrukturë
transporti; Inxhinieri strukturash;
MP. “Menaxhim”;
Msc. (PI) “Drejtësi”;
MP. 2 vj. “Komunikim dhe Media Digjitale”
MP. “Informatikë e Aplikuar” me profile: Dezinjim dhe
zhvillim aplikimesh; Menaxhim të dhënash; Siguria e
Sistemeve të informacionit; Menaxhim dhe vlerësim
projektesh;
Msc. “Infermieri”;
Msc “Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimeve”;

nj. Universiteti “Polis”:

Msc. “Dizajn i Aplikuar”;
Msc. “Menaxhim Mjedisor Urban”;

o. Kolegji Universitar “BEDËR”:

Msc. “Shkenca Komunikimi”, me profile: Marrëdhënie me
Publikun; Gazetari;

p. Universiteti “Metropolitan Tirana”:

Msc. “Marketingu Digjital”;

q. Kolegji Universitar i Biznesit:

Msc (PI). “Drejtësi”;

r. Universiteti “Western Balkans”:

Msc. “Nanoteknologji”;

s. Universiteti i New York-ut në Tiranë:

Msc (PI). “Drejtësi”;
Msc (PI) “Arkitekturë”;
Msc. “Shkencë të Dhënash dhe Analitikë Biznesi”;

t. Akademia e Forcave të Armatosura:

MP. "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbojtjes";

D .Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të tretë:

a. Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

SPA 3 vite "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive";

SPA 3 vite "Ortopedi Traumatologji";

SPA 3 vite "Gjinelologji dhe Obsetrikë";

SPA 3 vite "Kirurgji e Përgjithshme";

SPA 3 vite "Nefrologji";

b. Universiteti European i Tiranës:

Doktoratë "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes";

c. Universiteti "Albanian University"

SPA "Ortognatodonci";

d. Universiteti "Metropolitan Tirana":

Doktoratë "Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente";

E. Vlerësimi i jashtëm institucional:

a. Universiteti "Luarasi":

Institucional

b. Akademia e Forcave të Armatosura:

Institucional

c. Kolegji Universitar "Wisdom":

Institucional

d. Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi":

Institucional

e. Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School":

Institucional

f. Kolegji Universitar "TBU":

Institucional

g. Kolegji Universitar “I Biznesit”:

Institucional

F. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë, ekspertë të huaj

a. Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë:

Msc. “Etika dhe Liderhipi”;

Msc. “Financë”;

b. Universiteti Privat “Albanian University”:

Msc. “Administrim Publik “me profile: Politika Publike dhe BE; Politika Publike dhe Qeverisje;

c. Universiteti i Tiranës:

Msc (PI) “Drejtësi”;

Msc. “Marrëdhënie Ndërkombëtare”;

d. Universiteti i New York-ut në Tiranë:

Msc. “Shkencë të Dhënash dhe Analitikë Biznesi”;

G. Vlerësimi i jashtëm institucional me ekspertë të huaj

a. Universiteti “Luarasi”:

Institucional

b. Akademia e Forcave të Armatosura:

Institucional

c. Kolegji Universitar “Wisdom”:

Institucional

d. Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”:

Institucional

e. Kolegji Universitar “TBU”:

Institucional

f. Kolegji Universitar “I Biznesit”:

GJ. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të tretë, ekspertë të huaj:

a. Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”:

SPA 3 vite “Ortopedi Traumatologji”;

b. Universiteti European i Tiranës:

Doktoratë “Shkenca Sociale dhe të Sjelljes”.

II. ASCAL është pjesë e hapësirës europiane të sigurimit të cilësisë duke bashkëpunuar më të gjithë aktorët e kësaj fushe dhe duke qenë anëtar i asociuar i ENQA, anëtar me të drejta të plota i CEENQA, anëtar me të drejta të plota i INQAAHE. Gjithashtu ASCAL ka bashkëpunime të suksesshme me QAA dhe CHE. ASCAL ka paguar tarifat e anëtarësimit në organizmat ndërkombëtare ENQA, CEENQA dhe INQAAHE.

KAPITULLI III

SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE

3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE

ASCAL, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale, monitoron ecurinë e proceseve të ndryshme bazuar në mbledhjen e të dhënave në kohë reale. Bazuar në punën e bërë ndër vite, Agjencia disponon një nga platformat më të rëndësishme të të dhënave në arsimin e lartë e cila përveç mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave mundëson kryerjen online të procedurave në kuadrin e akreditimit të institucioneve/programeve të arsimit të lartë si:

- Menaxhim i procedurave të akreditimit institucional dhe programeve të studimit me ndërfaqe të dedikuara;
- Vlerësime në kuadrin e akreditimeve të para dhe periodike;
- Menaxhim të komunikimeve elektronike e postare;
- Menaxhim shërbimesh nga IAL dhe ndjekje në kohë të proceseve në etapa të ndryshme;
- Komunikim me institucionet dhe ekspertët;
- Realizim i vlerësimit *on-line* për IAL dhe programe nga ekspertë vendas dhe të huaj;

- Plotësim të pyetësorëve dhe publikimi i rezultateve;
- Akses për përdoruesit i cili mundësohet nëpërmjet modulit *on-line* me mundësi aksesimi sipas hierarkisë dhe funksionit.

Edhe në vitin 2025 AMS e ka lehtësuar menaxhimin e proceseve të akreditimit pavarësisht sasisë së informacionit të administruar. Në tërësi, AMS, nga IAL-të dhe ekspertët e vlerësimit, ka marrë vlerësim maksimal për lehtësinë, efikasitetin, transparencën dhe mundësitë që ofron për proceset që menaxhohen nëpërmjet këtij sistemi.

3.2 ADMINISTRIMI I PROCESVEVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMI I CILËSISË

Në vitin 2025, nëpërmjet AMS, ASCAL ka realizuar administrimin e rreth **758** shërbimeve (akreditime, vlerësime, informime, raportime, etj). Në bazë të Manualit të ASCAL, janë digjitalizuar të gjitha hapat që ndiqen në një procedurë vlerësimi për akreditimin institucional ose programeve të studimit.

Nëpërmjet AMS, për një procedurë akreditimi janë ndjekur hapat si vijon:

- Aplikimi për akreditim gjatë periudhës 1 tetor – 31 maj, të paktën 1 vit para diplomimit të studentëve të parë për institucionet e reja apo përfundimit të akreditimit të parë ose akreditimit periodik;
- Shqyrtimi paraprak i përputhshmërisë ligjore të kërkesës së akreditimit dhe verifikimi i bazës ligjore të funksionimit të institucionit nga data e themelimit (për institucionet me akreditim të parë) dhe nga data e akreditimit paraardhës;
- Miratimi i periudhës së akreditimit nëpërmjet konfirmimit për fillimin e procesit të akreditimit duke përcaktuar periudhën e akreditimit (datën e fillimit dhe mbarimit të procesit);
- Ngarkimi elektronik i DVV-ve;
- Shqyrtimi i dokumentacionit nga GVJ dhe dërgimi i draft-RVJ-ve dhe i RVJ final.

Gjatë vitit 2025, në çdo hap të procesit të akreditimit, stafi i ASCAL ka qenë në kontakt me koordinatoret e IAL-ve duke shkëmbyer informacione dhe dokumente nëpërmjet AMS. Ndjekja në kohë reale e procedurave nëpërmjet AMS ka ndihmuar të gjithë aktorët të

koordinojnë aktivitetet duke respektuar afatet kohore dhe njëkohësisht duke rritur transparencën.

Në fillimin e vitit akademik 2025-2026, IAL-të nëpërmjet koordinatoreve dhe në përgjigje të kërkesës së ASCAL, kanë përditësuar informacionin në AMS për stafin e tyre akademik, ndryshimet strukturore, programet aktive dhe jo aktive, studentët që ndjekin studimet për vitin akademik 2025-2026, etj. ASCAL ka shqyrtuar të dhënat e depozituara përkundrejtë standardeve dhe kriterëve për sigurimin e cilësisë dhe kur ka qenë e nevojshme ka kërkuar informacione shtesë ose saktësim të dhënash. Në këtë aspekt, ASCAL ka hasur vështirësi për shkak të mosraportimit në kohë reale dhe brenda afatit të përditësimeve përkatëse, raportimit të të dhënave jo të sakta nga IAL-të, etj.

Si rezultat i informacionit të mbledhur ndër vite, aktualisht AMS përbën databazën më të madhe të arsimit të lartë në Shqipëri. Në këtë databazë, gjatë vitit 2025 janë administruar rreth **4549 dokumente** të ndara sipas llojit, kategorisë, gjuhës, etj. Po ashtu, nëpërmjet AMS, janë regjistruar një numër i madh komunikimesh ndërmjet ASCAL, BA, ekspertëve dhe IAL-ve, si dhe janë shkëmbyer mjaft dokumente shtesë ose informuese. I gjithë informacioni i ruajtur në AMS është lehtësisht i administrueshëm dhe i përdorshëm në funksion të çdo procesi/procedure dhe aktiviteti të ASCAL dhe BA duke rritur transparencën dhe gjithëpërfshirjen.

Statistika mbi dokumentat e arkivës

E gjithë korespondenca midis ASCAL dhe institucioneve të arsimit të lartë, gjithashtu dhe institucioneve të tjera, ngarkohet në sistemin e brendshëm AMS.

Të shtuara në arkivë janë gjithsej **4549** dokumenta, të shpërndara sipas llojit në: vendime, urdhëra, shkresa, raporte të vlerësimit të jashtëm, draft-raporte të vlerësimit të jashtëm, raporte vjetore, autorizime, rregullore, kërkesa, njoftime, kontrata, vërtetime, etj.

3.3 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

ASCAL, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut, ndër vite ka ndërtuar një sistem të konsoliduar për dhënien e informacionit dhe informimin e publikut bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit.

Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ASCAL ka miratuar programin e transparencës dhe e ka publikuar në faqen zyrtare. Ky program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASCAL/BA, nëpërmjet pasqyrit në faqen zyrtare si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit e cila pasqyron *menu*-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare. Në këtë program transparence ASCAL ka paraqitur gjithashtu mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik.

Për **vitin 2025**, referuar regjistrin të dhënies së informacionit, ASCAL u është përgjigjur zyrtarisht dhe ka dhënë informacion/dokumente, për **376 kërkesa zyrtare** nga të cilat **33** janë bërë me formular aplikimi/shkresë zyrtare dhe **343** nëpërmjet portalit e-Albania. Kryesisht, këto kërkesa, të depozituara nga individë të ndryshëm, kanë patur të njëjtin objekt. Gjatë vitit 2025, ASCAL ka dhënë informacione dhe sqarime të ndryshme edhe nëpërmjet AMS dhe u është përgjigjur një numri të madh *e-mail*-esh të publikut në tërësi duke u dhënë informacionin e kërkuar ose duke i adresuar në institucionet kompetente.

Në kuadër të transparencës dhe informimit në kohë reale, faqja zyrtare e ASCAL mundëson informacion për publikun dhe palët e interesuara në format të kuptueshëm. Faqja e ASCAL lexon të dhënat në kohë reale nga AMS duke garantuar për publikun dhe palët e interesuara informacion të përditësuar dhe të besueshëm. Edhe në vitin 2025, në faqen zyrtare të ASCAL janë pasqyruar aktivitetet e Agjencisë dhe BA si dhe vendimet për akreditimin e programeve të studimit dhe IAL-ve. Nëpërmjet “*search engine*” në faqen e ASCAL, studentët, publiku i gjerë si dhe palët e tjera të interesuara mund të marrin informacion të plotë mbi vlefshmërinë e akreditimit të programeve të studimit apo IAL-ve, proceset e vlerësimit që kanë kaluar programet e studimit dhe IAL-të si dhe RVJ-të përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur, disa nga informacionet e të dhënat që i vihen në dispozicion publikut dhe palëve të interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të ASCAL janë:

- Informacion për procesin e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit me të dhëna për çdo proces të zhvilluar nga çdo program studimi dhe IAL;
- Raporte të vlerësimit të jashtëm institucional dhe të programeve të studimit;

- Vendime të Këshillit të Akreditimit dhe Bordit të Akreditimit;
- Publikime të akteve/bazës ligjore mbi të cilat bazohet procesi i vlerësimit të jashtëm si Ligji 80/2015, VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar, VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, etj.;
- Raporte vjetore, rregullore, udhëzues, modele RVB dhe RVJ, etj.

3.4 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE

Procesi për menaxhimin dhe administrimin e informacionit/dokumentacionit në ASCAL zbatohet nga arkiva/protokolli i institucionit. Çdo dokument ruhet në formë fizike dhe elektronike në arkivën dhe databazën e institucionit në përputhje me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”. Në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera të ruajtjes së informacionit zyrtar, ASCAL klasifikon informacionin sipas statusit të tij, *publik, përdorim të brendshëm, konfidencial dhe sekret*. Po ashtu dhe aksesit në dokumentacion për stafin e ASCAL, BA dhe ekspertët, bëhet në funksion të procesit/procedurës së cilës i përket dokumentacioni.

Aspekte të përdorimit të informacionit të brendshëm të ASCAL dhe mënyrës së dhënies së tij, janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

Në funksion të proceseve të vlerësimit dhe akreditimit, së bashku me dosjen e printuar, në ASCAL dorëzohet edhe versioni elektronik i saj.

KAPITULLI IV

PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2026

ASCAL ka si objektiv kryesor: (i) sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm, (ii) garantimin dhe ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe (iii) përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe në programet e studimit që ato ofrojnë.

Në përputhje me këto objektiva, gjatë vitit 2026, ASCAL parashikon të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:

1. Zhvillimi i procedurave dhe aktiviteteve në kuadër të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, konkretisht:
 - a. Kryerja e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë dhe/ose programeve të tyre të studimit;
 - b. Rishikimi dhe përmirësimi i formateve të raporteve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;
 - c. Vlerësimi i vazhdueshëm i funksionimit dhe efektivitetit të sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë në IAL;
 - d. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e arsimit të lartë për garantimin e mbarëvajtjes së proceseve të vlerësimit të jashtëm;
 - e. Mbështetja e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit;
 - f. Zhvillimi i aktiviteteve në bashkëpunim me aktorë të tjerë në fushën e arsimit të lartë;
2. Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimit të plotë për anëtarësim me të drejta të plota në ENQA dhe për regjistrim në EQAR, në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG);
3. Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimit të plotë për anëtarësim me të drejta të plota në CHEA;
4. Angazhimi i përfaqësuesve të studentëve dhe të tregut të punës në proceset e vlerësimit të jashtëm, si dhe në mbledhjet e Bordit të Akreditimit;
5. Zhvillimi i procesit të monitorimit përgjatë gjithë vitit dhe pas akreditimit, si dhe hartimi dhe standardizimi i formateve të planit të veprimit të IAL-ve dhe të raporteve të monitorimit;

6. Hartimi i raporteve tematike, me qëllim analizimin e thelluar të çështjeve prioritare dhe të gjetjeve të përsëritura që dalin nga proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë, bazuar në të dhëna të strukturuar dhe analiza krahasuese;
7. Konsolidimi i mekanizmit gjithëpërfshirës për mbledhjen e feedback-ut, duke përfshirë komente, vlerësime dhe sugjerime nga të gjithë aktorët e përfshirë në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë, si dhe organizimin e fokus-grupeve me ekspertë të vlerësimit të jashtëm, përfaqësues të tregut të punës, studentë dhe institucione të arsimit të lartë;
8. Pjesëmarrja aktive në projekte ndërkombëtare ku ASCAL është partner, si dhe rritja e numrit të aplikimeve në projekte të reja;
9. Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës aktuale të teknologjisë së informacionit, si dhe përmirësimi i faqes zyrtare të internetit;
10. Organizimi dhe pjesëmarrja në workshop-e, konferenca, trajnime, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të forcimit të kapaciteteve në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.